



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET
PALËVE TË KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EVROPËN
JUGLINDORE, PËR SHKËMBIMIN E AUTOMATIZUAR TË TË DHËNAVE TË ADN-
SË, DAKTILOSKOPIKE DHE TË TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT TË
AUTOMJETEVE, DHE MARRËVESHJES SË SAJ ZBATUESE”**

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të konventës së bashkëpunimit policor për Evropën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe institucionet përgjegjëse.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Me anë të këtij projektligji synohet forcimi i bashkëpunimit policor ndërkufitar, ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm, duke luftuar kërcënimet e sigurisë publike për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

Marrëveshja që ratifikohet përmban rregullat për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Me anën e shkëmbimit automatik të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike, Shqipërisë i krijohet mundësia që të shfrytëzojë bazat e të dhënave të shteteve të tjera që do të bëhen palë të marrëveshjes, duke i dhënë akses që të kontrollojë profilet e ADN-së, shenjat daktiloskopike dhe të dhënat e regjistrimit të automjeteve, si të shtetasve shqiptarë ashtu dhe profilet e ADN-së të ngjarjeve kriminale të ndodhura në Shqipëri, me qëllim identifikimin on-line të personave që janë përfshirë në këtë aktivitet kriminal apo kanë ndryshuar të dhënat e tyre identifikuese, emër, mbiemër etj.

Për arritjen e këtij shkëmbimi palët kanë përcaktuar në marrëveshje rregullat dhe dispozitat mbi kushtet e nevojshme administrative dhe teknike, rregullat për caktimin e pikave të kontaktit dhe sigurimin e disponueshmërisë të të dhënave.

Efektet financiare

Palët me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, do të krijojnë vetëm bazën ligjore të bashkëpunimit me qëllim për të punuar hap pas hapi mbi ngritjen e kapaciteteve për zbatim. Me ngritjen e këtyre kapaciteteve do të planifikohen edhe kostot shtesë të nevojshme për implementimin e rrjetit TESTA, apo për shkëmbimin automatik të të dhënave të regjistrimit të automjeteve në sistemin EUCARIS.

Diskutimet në Komision :

Të ftuarit shpjeguan rëndësinë e kësaj marrëveshjeje në fushën e bashkëpunimit policor ndërkufitar dhe në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale. Anëtarët e Komisionit vlerësuan nismën e propozuar, kërkuar informacion mbi rregullat e zbatimit të këtij shkëmbimi, mbi marrëdhëniet me palët e marrëveshjes dhe mbi pritshmëritë që synon të realizojë zbatimi i saj.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI

